

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, në faqen e internetit të Librit Kosovarë të Kujtimeve (PZAP) është vendosur regjistri i të vrarëve dhe të zhdukurve në luftën e Kosovës, në periudhën nga 1 janari 1998 deri në 31 dhjetor 2000, raporton Anadolu Agency (AA).

Regjistri përmban të dhëna personale të rreth 13.517 viktimave, datën, vendin e lindjes dhe vendbanimin deri në datën e vdekjes ose zhdukjes, si dhe vendin vrasjes apo zhdukjes, si dhe informacionet nëse viktimi ishte civil apo pjesëtar i forcave të armatosura. Të dhënat janë marrë nga baza e të dhënave të KPP, autorë i së cilës është Fondi Humanitar i Drejtësisë në Kosovë, njoftojnë nga kjo organizatë.

"Ky është një rezultat hulumtues disavjeçar, i cili bazohet në deklaratat e dëshmitarëve dhe të anëtarëve të familjeve, të marra nga hulumtuesit e FHD dhe FHPK, dhe të dhënave nga dokumentet e gjykatës, raportet mjeko-ligjore, të dhënat e forcave të armatosura, raportet e organizatave joqeveritare dhe mediat, ditarëve të luftës dhe dokumenteve të tjera", raportohet me rastin e publikimit të këtij informacioni.

Sipas bazës së të dhënave të KPP, të 7 nëntorit 2014 në lidhje me luftën në Kosovë kanë vdekur ose janë zhdukur 13.517 njerëz në total, duke përfshirë edhe jo civilët, ku: 10.415 janë shqiptarë, 2.197 serbë dhe 528 romë, boshnjakë dhe komunitete tjera jo-shqiptarë.

Në mesin e viktimave apo civilëve të zhdukur janë, 8661 shqiptarë, 1197 serbë dhe 447 romë, boshnjakë dhe komunitetet tjera jo-shqiptare.

Regjistri i të vrarëve ose të zhdukurve në lidhje me luftën në Kosovë është i vendosur në faqen e internetit të Librit Kosovar të Kujtimeve:

<http://www.liberkujtimiikosoves.org>,
<http://www.kosovskaknjigapamcenja.org>,
<http://www.kosovomemorybook.org>.